



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 6199/1, Prot.

Tiranë, më 18 . 12 .2020

**Lënda:** Kthim përgjigje

**REPORT TV**

**Z. ARSEN RUSTA**

I nderuar z. Rusta!

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e redaksisë suaj, në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion të datës 15.12.2020, regjistruar me numër rendor 267, datë 15.12.2020, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin Nr. 6199 Prot., datë 15.12.2020, referuar nenit 14§2§b të Ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor vijon punën intensive dhe po ndërmerr çdo hap të nevojshëm, për të përfunduar sa më parë procesin e plotësimit të vendeve të lira në Gjykatën e Lartë dhe në të gjithë sistemin gjyqësor, për të garantuar aksesin e qytetarëve në drejtësi. Në këtë kontekst, ju informojmë se KLGJ filloi procedurat për paraqitjen e kandidaturave për në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, menjëherë pas plotësimit të kuadrit nënligjor (Rregullat për kriteret dhe procedurën për promovimin e magistratëve në Gjykatën e Lartë - Vendimi Nr. 75, datë 23.05.2019; Rregullat për kriteret dhe procedurën për emërimin e jo gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë - Vendimi Nr.102 datë 5.07.2019). Në përfundim të procedurave të kandidimit për secilin nga pozicionet e lira të shpallura, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për të gjithë konkurrentët, si dhe vlerësimit sipas meritave të kandidatëve të kualifikuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi t’i propozojë Presidentit të Republikës emërimin e tre kandidatëve, me vendimet Nr. 110, 111 dhe 112, datë 27.2.2020, mbi bazën e të cilëve u emëruan si Gjyqtarë të Gjykatës së Lartë respektivisht me dekretet Nr.11452, 11453 dhe 11454, datë 11.03.2020, të Presidentit të Republikës. Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin për pozicionin e katërt nga radhët e juristëve të spikatur. Në mbledhjen e datës 13.11.2020, në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, të kandidatit të fundit nga radhët e juristëve të spikatur, Këshilli vendosi kualifikimin dhe vijimin e fazës së dytë, të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes, të z. Darjel Sina. Shih: <http://klgj.al/njofim-per-shtyp-date-13-nentor-2020/>

Vendimi Nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” i hapi rrugë edhe promovimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë. KLGJ, me qëllim plotësimin e pozicioneve të tjera të lira në Gjykatën e Lartë, në mbledhjen e datës 26.2.2020, vendosi fillimin e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve. Me vendimet Nr. 82, 83 dhe 84 datë 26.02.2020, është vendosur fillimi i procedurës së ngritjes në detyrë, në Gjykatën e Lartë, për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës administrative, si dhe me vendimet Nr. 85, 86 dhe 87, datë 26.02.2020, është vendosur fillimi i procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës civile. Për vendimet e sipërpërmendura, Këshilli ka caktuar relatorët, si dhe ka përfunduar fazën e parë të verifikimit të plotësimit të kriterëve formale dhe ligjore. Informacion mbi procedurat e promovimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë gjendet në linkun e mëposhtëm:

<http://klgj.al/njoftim-per-shpalljen-e-procedures-se-ngritjes-ne-detyre-ne-gjykatën-e-larte/>

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 09.07.2020, me vendimet Nr. 241, 242, 243, 244 dhe 245, vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për katër pozicione të lirë në fushën e të drejtës penale dhe një pozicion në fushën e të drejtës administrative. Për vendimet e sipërpërmendura, Këshilli ka caktuar relatorët, si dhe ka nisur procesin e mbledhjes së dokumentacionit përkatës nga institucionet e caktuara me ligj. Informacion më i detajuar gjendet në linkun:

<http://klgj.al/njoftim-per-shpalljen-e-procedures-se-ngritjes-ne-detyre-ne-gjykatën-e-larte/>

Në mbledhjen e datës 26.11.2020, për shkak të tërheqjes nga kandidimi, Këshilli vendosi përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë, për dy candidate për në Gjykatën e Lartë. Informacion më i detajuar gjendet në linkun: <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-26-nentor-2020/>

Në lidhje me numrin e kandidatëve për çdo pozicion të shpallur, informacioni i plotë gjendet në linkun: <http://klgj.al/njoftim-per-shpalljen-e-procedures-se-ngritjes-ne-detyre-ne-gjykatën-e-larte/>

Gjithashtu, referuar vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, Këshillin i Lartë Gjyqësor duhet të vijojë procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për një candidate. Në zbatim të këtij vendimi, KLGJ vendosi në datën 10.12.2020, fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për znj. Saida Dollani, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura në datën 09.07.2020. Informacion më i detajuar gjendet në linkun: <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-10-dhjetor-2020/>

Për vendet vakante në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, aplikuan 23 kandidatë, nga të cilët 4 kandidatë janë kualifikuar, ndërsa të tjerët janë tërhequr nga kandidimi ose janë skualifikuar për shkak të mosplotësimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit, të tilla si: ndalimi i riemërimit gjyqtar në Gjykatën e Lartë, mosmbajtjes së gradës shkencore në drejtësi;

largimit nga detyra për shkaqe disiplinore si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; mosplotësimin të kriterit të përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës; të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit.

Për vendet vakante në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, kanë aplikuar 23 kandidatë, nga të cilët 2 kandidatë janë tërhequr nga kandidimi, ndërsa 15 kandidatë janë kualifikuar, për të cilët është marrë vendim i formës së prerë nga organet e rivlerësimit kalimtar/vettingut, 1 kandidat është në pritje për t'u kualifikuar, 1 kandidat është konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendim që ende nuk është arsyetuar e nuk ka marrë formë të prerë, ndërsa 4 kandidatë janë në proces rivlerësimi kalimtar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Në lidhje me pyetjen tuaj nëse KLGJ ka një afat, parashikim, se kur do të mbyllet kjo procedurë dhe kur do të emërohen gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, ju informojmë se afatet kohore nuk mund të jepen me saktësi, për shkak të procesit kompleks të procedurës së emërimit, që përfshin një sërë institucionesh në vend. Megjithatë, Këshilli ju siguron se do ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për të përfunduar sa më parë procesin e plotësimit të Gjykatës së Lartë, duke mbajtur në konsideratë gjithmonë cilësinë e kandidatëve që do përzgjidhen.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**RUDIN BAQLI**

